

QKB



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI
ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësia,
Pall. Moskat, shk 3, ap 14"
TEL: 692204572

KONTRATË DHURIMI PASURI E LUAJTSHME (KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 652

Nr. koleksioni: 330

Tirane më 09/02/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 2 fletë



A2021050360007084976



A2021050360007084976

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot, më datë 09/02/2021, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, Rruga "Muhamet Gjollësia, Pall. Moskat, shk 3, ap 14", u paraqit personalisht:

DHURUESI: Z. Naun Mishaxhi, atesia Pandeli, i datelindjes 05.09.1975, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga leternjoftimi me numer personal H50905114R, perfaqesuar me prokure nga **Z.Pandeli Mishaxhi**, atesia Naun, i datelindjes 16.02.1943, lindur ne Berat dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, identifikuar nga leternjoftimi me nr. personal E30216113P.

PRANUESI I DHURIMIT: Z.Kris Ferko, atesia Dritan, i datelindjes 15.02.1997, lindur ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me numer personal J70215084B

Palët bien dakord si me poshtë vijon:

NENI 1- Kushte të përgjithshme

- 1.1. **Pala dhuruese Naun Mishaxhi**, eshte ortak i shoqërisë me përgjegjësi te kufizuar "**PremiumGames**" sh.p.k, e cila është një person juridik shqiptar, e themeluar dhe regjistruar sipas legjislacionit ne fuqi ne Republikën e Shqipërisë, në Qendren Kombetare te Regjistrimit, me nr. NIPT-i (NUIS) **M02823402L** dhe qe zotërohet përkatësisht nga:
- **Z. Naun Mishaxhi**, zoteron 50 % te kapitalit te shoqërisë qe perfaqeson 1 pjese te kapitalit te shoqërisë me vlere 50.000 leke (pesedhjetë mije leke).
 - **Z. Kris Ferko**, zoteron 50 % te kapitalit te shoqërisë qe perfaqeson 1 pjese te kapitalit te shoqërisë me vlere 50.000 leke (pesedhjetë mije leke).
 -
- 1.2 Me Vendimin e Asamblesë së Përgjithshme te Ortakut te vetem te datës 07.09.2020, te shoqërisë "**PremiumGames**" sh.p.k, nder te tjera është vendosur:
- a) Dhurimi i 50 % e barabarte me 1 (nje) kuote të kapitalit të shoqërisë "**PremiumGames**" sh.p.k që zotërohet rregullisht në masën 50 % e barabarte me 1- kuote te kapitalit te shoqërisë me vlere 50.000 leke (pesedhjetë mije leke) nga ortaku **Naun Mishaxhi** tek **Kris Ferko**, duke perfituar:
 - **Kris Ferko** 50 % te kapitalit te shoqërisë te zoteruar nga **Naun Mishaxhi**.

Kris Ferko, do te zotëroje 100 % te vleres se kapitalit te shoqërisë qe perfaqeson 1 kuote te kapitalit te shoqërisë me vlere 100.000 leke (njehind mije leke).

Me Vendimin e ortakut te dates 07.09.2020 të Shoqërisë "**PremiumGames**" SH.P.K, është vendosur dhurimi i 50 % te kapitalit te shoqërisë e barabarte me 1 - kuote te shoqërisë "**PremiumGames**" SH.P.K nga pala dhuruese **Naun Mishaxhi** tek pala pranuese e dhurimit **Kris Ferko**.



A2021050360007084976

NENI 2- OBJEKTI

Objekt i kësaj kontrate është dhurimi i 50 % te kapitalit e barabarte me 1- kuote te Shoqërisë **“PremiumGames” SH.P.K**, me vlerë 50.000 leke (pesedhjetë mijë leke), nga pala dhuruese Naun Mishaxhi tek pala pranuese e dhurimit **Kris Ferko**.

NENI 3 – BAZA LIGJORE

Baza ligjore e kësaj kontrate dhurimi ne Kodin Civil, Ligji 9901, date 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

NENI 4- TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE

Me nënshkrimin e kësaj kontrate pala dhuruese, perkatesisht Naun Mishaxhi, zhvishet nga pronesia e 50 % te kapitalit te shoqërisë e barabarte me 1 -kuote te shoqërisë **“PremiumGames” SH.P.K**, dhe pala pranuese e dhurimit **Kris Ferko** behet ortak i shoqërisë **“PremiumGames” SH.P.K** duke zoteruar 100 % te kapitalit te shoqërisë.

4.2 Me nënshkrimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash, shoqëria **“PremiumGames” SH.P.K** behet shoqëri me nje ortak te vetem, kapitali i se ciles është nënshkruar plotësisht dhe zotërohet si me poshtë:
- **Kris Ferko**, qe zotëron 100 % te vleres se kapitalit themeltar, te shoqërisë qe perfaqeson 1 pjese te kapitalit te shoqërisë me vlere 100.000 leke (njëqind mijë leke).

4.3. Palet bien dakord qe me nënshkrimin e kesaj kontrate te gjitha pergjegjesite ligjore dhe financiare qe lindin nga nënshkrimi i kesaj kontrate si dhe nga qenia ortak i shoqërisë **“PremiumGames” sh.p.k**, para dhe pas nënshkrimit te ketij akti, jane ne ngarkim te pales pranuese te dhurimit **Z. Kris Ferko**.

NENI 5- TE NDRYSHME

5.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen dhe janë në pjesë përbërëse e saj dokumentacioni si më poshtë vijon:

1- Vendimi 07.09.2020 i Asamblesë së ortakeve te Shoqërisë **“PremiumGames” sh.p.k**.

3. Ekstrakti QKB-së se historikut te shoqërisë **“PremiumGames” sh.p.k**

4. Kopje te kartave te identitetit te nënshkruesve të kontratës.

5.2. Kjo është një kontratë dhurimi kuotash e përpiluar në katër kopje dhe pasi lexohet me zë të lartë dhe gjendet në përputhje të plotë me vullnetin e palëve kontraktuese, nënshkruhet rregullisht para meje noteres.

PALET KONTRAKTUESE

DHURUESI

NAUN MISHAXHI

perfaqesuar me prokure nga

PANDELI MISHAXHI

Pandeli Mishaxhi
Pandeli

PRANUESI I DHURIMIT

KRIS FERKO

Kris Ferko



Dt. 07/09/2020

VENDIM
I ASMABLESË SË PËRGJITHSHME TË ORTAKËVE TË SHOQËRISË
"PremiumGames" sh.p.k
NUIS- M02823402L

Shoqëria "**PremiumGames**" sh.p.k. me seli në adresën: Rr. Lagjia "29 Nentori", "Kastriot Muco", Banesa 7/1 Fier, me NUIS: **M02823402L** është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me ortakë:

1. **Naun Mishaxhi** ortak i shoqërisë zotërues i 50 % të kapitalit të shoqërisë.
2. **Kris Ferko** ortak i shoqërisë zotërues i 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve u mbledh sot për të diskutuar dhe vendosur mbi rendin e ditës:

- Miratimin e kontrates se dhurimit se 50 % kuotave të shoqërisë nga ortaku Naun Mishaxhi tek ortaku tjetër i shoqërisë z. Kris Ferko.

Ortakët pasi diskutuan rendin e ditës të paracaktuar si më sipër, në përputhje të plotë me Ligjin nr. 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve:

Vendosi:

- Miratimin e kontrates se dhurimit të 50 % kuotave të shoqërisë nga ortaku Naun Mishaxhi tek ortaku tjetër i shoqërisë z. Kris Ferko.
- Ngarkohet administratori i shoqërisë për zbatimin e këtij vendimi dhe regjistrimin e tij pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Ortakeve

NAUN MISHAXHI

Naun Mishaxhi
Ny

KRIS FERKO

Kris Ferko
[Signature]

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20210209143424405
Data e Rezultatit te Kerkimit: 09.02.2021
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 2:34:24PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-481-966
Referenca e Perdoruesit:


LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

NAUN PANDELI MISHAXHI
PREMIUMGAMES SH.P.K.
KRIS DRITAN FERKO



Arta Jaku





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE

Nr 3352 Rep

Nr 1667 Kol

PROKURË E PËRGJITHSHME

Sot më date 27.09 2020, para meje Noteres Margalina Y.Dauti pranë Dhomes së Noterisë Tirane, me seli në adresë Rruga "Muhamet Gjollësja, Pall. Moskat, shk.3, ap.14, u paraqit personalisht e interesuara si më poshte, e cila në baze të nenit 70 e vijues të Kodit Civil kërkoj redaktimin e këtij akti si vijon:

I PËRFAQËSUARI:

Z. Naun Mishaxhi, atesia Pandi, i datelindjes 05.09.1975, lindur në Berat dhe banues në Kanada, madhor dhe me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, mbajtes i letërnjoftimit me nr. personal H50905114R

i cili më kërkoj redaktimin e kësaj prokure të përgjithshme duke deklaruar se:

Une i përfaqesuari i mesipër emëroj si përfaqësuesit e mi **Z.Pandeli Mishaxhi**, atesia Naun, i datelindjes 16.02.1943, lindur në Berat dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal E30216113P dhe **Znj.Stefani Mishaxhi**, atesia Thimi i datelindjes 19.06.1948, lindur në Perondë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plote juridike dhe për të vepruar, identifikuar nga letërnjoftimi me nr. personal E85619053K., të cileve të dy së bashku ose secili vec e vec u dekloroj pushtetet që një e lejon ligji, për të vepruar, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të mia të profesionale dhe/ose pasurore, për tu interesuar për çfarëdoq problemi dhe/ose shkakut tjetër, objekti, pakufizim, kuptohet kujtdo personi privat ose shtetëror, personave fizike dhe juridike, private ose shtetërore, individe, etj. të cilat kanë vepruar dhe veprojnë për shkeljen e këtyre të drejtave dhe interesave.

Ata kanë të drejta dhe kompetenca të plota që të dy së bashku ose secili vec e vec të paraqiten pranë çdo zyrtar noterialë për të nënshkruar kontrata shitje, kontrata dhurimi, kontrata qeraje, (për të gjitha pronat në të cilat une jam pronar, të luajtshme ose të paluajtshme), kontrata për dhenien e truallit në dispozicion të shoqërive të ndërtimit, kontrata shkëmbimi, revokime, deklarata të ndryshme, kontrata premtim shitje kalim të drejtash reale, kontrata pjesëtimi, deklarata heqje dore, deklarata për ndarje ose bashkim pronash, kërkesa dhe çdo akt tjetër që parashikon ligji për tjetërsimin e pasurive për pjesën time të bashkepronësisë për të gjitha pasuritë që janë në emrin tim apo në bashkepronësi.

Të përfaqesuarit e mi kanë të drejtë të vendosin vetë për cmimin e shitjes apo të qirase, të vendosin vetë për cmimin dhe mënyrën e likuidimit por të gjitha shumat e përfituara nga shitja e pasurive që janë në pronësi apo në bashkepronësi time, do të kalojnë në nr. tim të llogarise.

Gjithashtu përfaqesuesit e mi kanë të drejtë të nënshkruajnë çdo dokument që është i nevojshëm për të kryer veprimet e mesipërme.

Të paraqiten në emer dhe për llogarinë time pranë çdo organi administrativ të çdo lloji instance për të gjitha pronat të cilat janë në pronësi time apo në bashkepronësi me të tjerë.

Tel 069 22 04 572

E-mail: dautigina@gmail.com


NOTERE
Margalina Dauti (Karteri)

Kane të drejte të paraqiten pranë ASHK, Agjencine e Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale si dhe cdo institucioni tjetër (komune, prefecture, bashki, njesi bashkiake, arkive shtetërore apo noteriale, etj.) pa asnjë kufizim, për të kryer cdo veprim në lidhje për cdo prone e cila është në pronësi time apo në bashkepronësi me të tjerë.

Ata kanë të drejte të paraqiten në organet administrative dhe institucione shtetërore për tu interesuar për cdo lloj dokumenti për keto prona.

Ata janë të autorizuar dhe të ngarkuar, për të vepruar në emër dhe për llogarime time, për mbrojtjen dhe përfaqësimin tim në të gjitha shkallët e gjyqimit, përpara të gjitha gjykatave në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga kompetencat dhe juridiksioni, për të redaktuar, nënshkruar dhe paraqitur përpara gjykatave çfarëdoj dokumenti dhe akti, kërkesë, kërkesë padi, kundër padi, prove, ankimi dhe kundër ankimi, rekursi dhe kundërrekursi, vendosje të masave të sigurimit, nota verbale, konkluzione përfundimtare, zgjidhjen me pajtim të mosmarreveshjeve gjyqësore, deri në ekzekutimin përfundimtar të vendimeve të gjykatave, etj.

Ata kanë të drejte, që të dy së bashku ose secili veç e veç, të veprojnë edhe për të gjithë rastet e tjera të parashikuara në kete prokurë, për të me përfaqësuar për veprime që do t'u kërkohej si të tërheqin dokumenta dhe/ose cdo akt të nevojshëm dhe/ose të nënshkruajnë cdo dokument tjetër që do të jetë i nevojshëm në marrëdhëniet me organet gjyqësore, organet e gjendjes civile, zyrtarë e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, agjensin e kërkimit dhe kompensimit të pronave, të organeve të tjera të pushtetit dhe administratës, qendrore ose vendore, të bashkive, të komunave, të keshillave të tyre, personat fizikë dhe juridikë, private dhe shtetërore, zyra noterie, dhe pse jo të përmendura në kete prokurë, pa qenë nevoja e ndonjë akti tjetër, me të cilën do të duhej të rishfaqja vullnetin tim për ratifikimin e tyre, pra në përgjithësi dhe në veçanti, mbrojtësit dhe përfaqësuesit e mi mbeten shprehimisht të autorizuar të bëjnë gjithçka, që do të bëja unë vetë, tagra të cilat edhe pse nuk janë përmendur shprehimisht në kete akt, duke mbetur ata me cilësi të pakundershtueshme për paqartësi të të drejtave ose mungesë të pushteteve të deleguara.

Ata kanë të drejte, gjithashtu, të emërojnë dhe revokojnë përfaqësues dhe/ose avokate të tjera, për të gjitha problemet që do t'i konsiderojnë të nevojshme, me të njëjtat pushtete që atij i janë deleguar ose me pushtete me të kufizuara.

Kjo prokurë, u jep përfaqësuesve pushtet dhe kompetenca të pakufizuara për të vepruar në të gjitha konfliktet gjyqësore, civile dhe/ose administrative, cilido që të jetë objekti i këtyre konflikteve dhe cilido të jetë pozicioni i tij, në emër dhe për llogarime time, padites, i paditur, person i tretë, person i interesuar, kallzues, etj., në të gjitha instancat gjyqësore si në gjykatën e rrethit gjyqësor, në gjykate të Apelit dhe në gjykate të Lartë deri në ekzekutimin e këtyre vendimeve me të drejtën e kundërshtimit me të gjitha tagrat e thena me lartë.

Ata kanë të drejte të zgjedhin zyren përbarimore, të kërkojnë leshimin e urdherit të ekzekutimit, të kërkojnë dhe të kundërshtojnë kryerjen e veprimeve përbarimore, të bëjnë kërkesa të ndryshme dhe të nënshkruajnë ato pranë Zyrtarëve të Përbarimit apo në adresat e tyre.

Gjithashtu përfaqësuesit e mi kanë të drejte të nënshkruajnë cdo dokument që është i nevojshëm për të kryer veprimet e mesipërme.

Kjo prokurë është e vlefshme për sa kohë nuk është revokuar nga ana ime me një akt të dytë të së njëjtes forme ose me ekzekutimin e tagrave të dhëna prej meje.

Tel 069 22 04 572

E-mail: dautigina@gmail.com



MD
NOTERE
Margalina Dauti (Kurteri)

Une i perfaqesuari deklaroi, pas redaktimit te kesaj prokure, se njoh qe tani dhe miratoj qe sot te gjitha veprimet e perfaqesuesit tim qe do te kryeje si te ligjshme, te rregullta, te vlefshme dhe te pacenueshme si te ishin kryer nga une vetete, me kusht qe ato te jene realizuar ne perputhje me porosite e dhena dhe ligjet ne fuqi.

Prokura u redaktua ne tre kopje me permbajtje dhe vlere te njejte juridike, ju lexua te perfaqesuarit me ze te larte dhe te qarte, i cili deklaroi se e ka kuptuar permbajtjen e prokures dhe pasojat ligjore qe rrjedhin prej saj dhe pasi u bind per shprehjen e vullnetit e tij te lire dhe te plote, e pranoi dhe nenshkroi pa verejtje ate para meje noteres.

Une, noterja, lejoj nenshkrimin nga i interesuari dhe legalizoj permbajtjen dhe nenshkrimin sipas ligjit.

I PËRFAQESUARI
NAUN MISHAXHI

Naun Mishaxhi



NOTERE
MARGALINA Y. DAUTI



Tel 069 22 04 572

E-mail: dautigina@gmail.com